

Tiranë me 03.02.2022

AKT THEMELIM I G&D CONSTRUCTION SH.P.K.

Une ortaku i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **G&D CONSTRUCTION SH.P.K.** kam hartuar keke Akt Themelim te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si me poshte :
z.Dritan Nesimi i biri i Ramazanit me datelindje 09.07.1989 dhe me dokument identifikimi **Nr.190709004A** lindur dhe banues ne Bulqize, madhore dhe me zotesi te plote Juridike per te vepruar, me vullnetin e saj te plote te lire dhe te sinqerte e iniciativen e lire private ,mbeshtetur ne Kushtetuten e Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, dhe ligjin 9901 dt.14.04.2008 i ndryshuar per tregetaret dhe shoqerite tregetare ne mbeshtetje te neneve 6 e vijues dhe 68 e vijues te ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 per Qendren Kombetere te Biznesit hartohet ky Akt Themelim i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **G&D CONSTRUCTION SH.P.K.**

NENI 1


FORMA LIGJORE

Forma ligjore do te jete Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar.

NENI 2

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Do te jen: **z. Dritan Nesimi i biri i Ramazanit me datelindje 09.07.1989** dhe me dokument identifikimi **Nr. 190709004A** lindur dhe banues ne Bulqize,

DRITAN NESIMI 

NENI 3

OBJEKTI I AKTIVITETIT TE SHOQERISE

Objekti i aktivitetit te shoqerise **G&D CONSTRUCTION SH.P.K.** do te jete

Te ushtroje veprimtari private ne fushen e ndertimit, punimeve te dheut, sistemime terencesh, prodhim te materialeve te ndertimit e te inerteve dhe tregtimin e tyre, ndertime objektesh civile, shkolla etj, montim,zbatim projektesh ne fusha te ndryshme te ndertimit, rikonstruksione objektesh.Import Eksport te mallrave te ndryshem si hidraulike,elektrike, elektroshtepiake, elektronike, hidrosanitare, transport te mallrave te ndryshme etj.

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria **G&D CONSTRUCTION SH.P.K.** do ta kete seline e saj ne **Bulqize,Lagjja e Re Rruga Gjeologu, Objekti 1, hyrja 7, ap 7, zona kadastrale 8611.**Ku do te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Shqiperise.Ajo mund te krijojte filjale te dyta dhe operative , perfaqesie apo agjensi edhe ne rrothe te tjera te Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj ne perputhje te ligjislacionit ne fuqi ne vendet ku ata krijohen. Selia e shoqerise munde te ndryshohetme vendimin e Ansamblese se ortakeve duke e depozituar ne Regjistrin Tregtare te QKB-se.


NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria **G&D CONSTRUCTION SH.P.K.** do ta kote nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike pa afat e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtare prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mund te shpërbëhet në çdo kohe dhe për çfardo shkak.

NENI 6

DRITAN NESTOR



KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltare i shoqerise fregtare G&D CONSTRUCTION SH.P.K. është 100.000 (Njeqindemije) Leke

a-z.Dritan Nesimi eshte zoteruesi i 1 kuote me vleren 100.000 (Njeqinde mije) Leke ku perfqeson 100% te vleres se Kapitalit Themeltare te Shoqerise G&D CONSTRUCTION SH.P.K.

Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfqesohen me letra me vlere ,do kuote perfqeson te drejten e nje vote.

NENI 7

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator i Shoqerise G&D CONSTRUCTION SH.P.K. do te jete z.Dritan Nesimi shtetase shqiptare e datelindjes 09.07.1989 me document identifikimi nr. 190709004A

Mandati i te cilës zgjat jo me shume se 5 (pese) vjete duke filluar nga dt 03.02.2022 deri me dt.03.02.2027 me te drejte rizgjedhjeje.

DRITAN NESIMI 22



NENI 8

KOPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ansambleja e pergjitheshme.
- b) Perfaqersoje shoqerine tregtare
- c) Kujdoset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- d) Pergadisi dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportine ecurisese veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjitheshme per miratim.
- e)
- f) Krijojne nje system paralajmerimi ne kohën e duhur per rrethanat, qew kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- g) Kryejn regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyruashme te shoqerise, siç parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.
- h) Raportoje perpara ansamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te ve

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e ortakut te vetemedhe ne raste kur, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjeteme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vleren me te larte se 5% (perqinde) te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryej te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshme. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizik e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqipetare apo te huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore te gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhënie me të tretët në emër të shoqërisë, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakëve te shoqerise. Administratori angazhon shoqerine ne mardheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasaojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete aktne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

NENI 9

DRITAN NESHTAJ 22

VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar te çdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor , me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtare prane Qendres Kombetare te Biznesit.

NENI 10

Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te saja te luajteshme dhe te paluajteshme kjo shoqeri mund te drejtohet Agjensive te Sigurimit ne Republiken eShqiperis.

NENI 11

ORGANI VENDIMMARRES

Ansambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqerise

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ansambleja e pergjitheshme e ortakeve eshte pergjergjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhteme.

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
 - b) ndryshimet e statutit
 - c) emerimin dhe shkarkimin e atministratoreve
 - d) percaktimin e shperblimeveper personat e permendur ne shkronjat e dhe qte kesaj pike
 - e) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabelle autorizuar
 - f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga atministratorët, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
 - h) Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit
 - i) Pjestimin e kuotave dhe anolimin e tyre
 - j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykata dhe ne procedimet e tjera ndaj atministratoreve
 - k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
 - l) Miratimi i rregullave procedurjale te mbledhjeve te ansamblese
 - m) Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute
- Ortaku mund te perfaqesohet ne ansamblene e pergjitheshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë.

DRITAN NESHKO

Administratori I shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në ansamblet e përgjithshme

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të ansambletë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese të njëjtin rend dite

NENI 12

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e ligjislacionit shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregëtarët Shoqërit Tregtare", Kodit Civil dhe çfardo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Ky Statut u redaktua në 3 ekzemplare me vlerë të njëjtit juridikë në gjuhën Shqipe, dhe pasi u lexua nga ortakët themelues të shoqërisë nënshkruhet me vullnetin e tërësorë të lirë faqe për faqe.

Ngarkohet të bëjë veprimet prapë Q.K.B-së z.**Dritan Ramazan Nesimi**

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

G&D CONSTRUCTION SH.P.K.

ADMINISTRATOR DHE ORTAK I VETËM

Z.Dritan NESIMI

DRITAN NESIMI

